



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-022

Prishtinë, më 8 dhjetor 2021, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 DHJETOR 2021

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Kujtim Shala dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Abelard Tahiri, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me pikat: *Kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hagë (Holandë).*

Pastaj, me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 11 tetor 2021,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 11 tetor 2021

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 11 tetor 2021.

* * *

Në lidhje me pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme, kryetari deklaroi se në të ardhmen do të caktohet vazhdimi i atyre seancave.
Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

* * *

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të hënën, më 13 dhjetor 2021, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-073 për ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në formë granti sipas Aktit për Ndihmë të Jashtme të vitit 1961 dhe Aktit për kontroll të shitjeve të armëve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-068 për ratifikimin e “amendamentimit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2016 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”,*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-069 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së*

Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Zvicrës, përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme nëpërmjet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbi programin Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-070 për pijet e forta alkoolike,

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina,

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-072 për bujqësi dhe zhvillim rural,

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-037 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,

12. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksave vjetore për vitin 2022,

13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020,

14. Debat parlamentar në lidhje me pagat në sektorin publik.

Në lidhje me pikën nr. 4 të lartshënuar të rendit të ditës për seancën plenare, kryetari tha se shqyrtimi i Projektligjit duhet të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, pasi i njëjti është proceduar nga Komisioni Funkcional para afatit të paraparë.

Ndërsa, në lidhje me procedimin e pikës Propozimi i dy (2) kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të paraparë për radhitje në rendin e ditës të seancës së re plenare, diskutuan: kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, dhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari deklaroi se kjo pikë shtyhet për një konsensus në lidhje me procedimin e saj në seancë plenare.

Po ashtu, Kryesia vendosi që Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit të radhitet në rendin e ditës të seancës plenare, me nr. 11, pasi që ndërkohë Komisioni Funkcional e ka proceduar raportin për këtë projektligj.

* * *

Në vazhdim, nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, propozoi që mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit të mbahen ditëve të hëna dhe seancat plenare të mbahen ditëve të enjte, si dhe e shtroi çështjen e mungesës së disa herëve të kuorumit për mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me propozimin e lartshënuar dhe të shtruar nga nënkryetari Kujtim Shala diskutuan kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

* * *

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Shkresa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Vjosa Osmani - Sadriu, në lidhje me adresimin e saj para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, në lidhje me adresimin e Presidentes, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës të mbajë seancë plenare, të mërkurën, më 22 dhjetor 2021, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, zonja Vjosa Osmani-Sadriu, para deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës.

2. Procedimi i Projektligjit për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë COVID-19

Kryesia, në lidhje me procedimin e nismës legislative të qytetarëve për Projektligjin për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative të qytetarëve “Projektligji për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së Pandemisë COVID-19”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3. Njoftimi në lidhje me konkursin për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se nga konkursi i shpallur për pesë anëtarë të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar dhe për dy anëtarë të këtij këshilli nga radhët e komuniteteve joshqiptare brenda afatit ligjor kanë aplikuar 18 kandidatë.

Ndërsa, Gjykata Kushtetuese në lidhje me këtë këshill me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit për shkarkimin e pesë anëtarëve të këshillit ka marrë vendim për masë të përkohshme deri më 15 dhjetor. Po ashtu, që Gjykata ka kërkuar që Kuvendi të përmbahet nga çdo veprim lidhur me zgjedhjen e pesë anëtarëve të këtij këshilli.

Ndërsa, në lidhje me dy pozitat për anëtarët e këtij këshilli nga komunitetet joshqiptare kanë aplikuar vetëm 2 kandidatë, e që është numër i pamjaftueshëm për të proceduar.

Kryesia, në fund, në lidhje me dy pozitat për anëtarë të këtij Këshilli nga radhët e komuniteteve joshqiptare, mori këtë:

V E N D I M

1. Rishpallet konkursi publik për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radhët e komuniteteve joshqiptare.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ta publikojë rishpalljen e konkursit nga pika një (1) e këtij vendimi.

4. Rekomandimi për shpalljen e konkursit për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa të Mediave

Kryesia, me rekomandim të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa të Mediave, mori këtë:

V E N D I M

1. Shpallet konkursi publik për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave ta publikojë konkursin publik nga pika një (1) e këtij vendimi.
5. *Njoftimi për mbajtjen e seminarit Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-S në Republikën e Kosovës*

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me mbajtjen e Seminarit Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATOS-s në Prishtinë, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e parapara për Seminarin Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili do të mbahet në Prishtinë, në muajin tetor 2022, sipas kërkesës nr. 08/726/Do-411, datë 8. 10. 2021.

6. Shqyrtimi i kërkesës për organizimin dhe mbulimin e shpenzimeve për Takimin VII të Komisionit të Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen të gjitha shpenzimet e bëra për organizimin dhe mbajtjen e Takimit VII të Komisionit të përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në shumën prej 993,50 euro, i cili është mbajtur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, prej 4 - 5 nëntor 2021, sipas kërkesave me nr. 08/740/Do-414, datë 14. 10. 2021 dhe nr. 08/742/Do-415, datë 14. 10. 2021.

7. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për debat parlamentar në lidhje me kancerin e gjirit

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartësuar, vendosi që shqyrtimi i saj të shtyhet.

8. Kërkesa e kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, mbështetur nga gjashtë (6) deputetë tjerë të këtij grupi, për debat parlamentar në lidhje me ngritjen enorme të çmimeve

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartësuar, vendosi që shqyrtimi i saj të shtyhet.

9. Kërkesa e kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, mbështetur nga gjashtë (6) deputetë tjerë të këtij Grupi për debat parlamentar në lidhje me pagat në sektorin publik

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartësuar, vendosi që debati parlamentar në lidhje me pagat në sektorin publik të radhitet në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet më 13. 12. 2021.

10. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për intervistimin e kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e drekave, kafeve dhe pijeve, në shumën prej 619,00 euro sipas faturave, të bëra nga Organi Përzgjedhës i Pavarur për intervistimin e kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për periudhën shtatë (7) ditore, gjatë muajin tetor 2021, sipas kërkesës nr. 08/768/Do-309/3, datë 21. 10. 2021.

11. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2021

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2021 sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Administrata e Kuvendit të Kosovës.

12. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve në lidhje me udhëtimin zyrtar në Budapest (Hungari)

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit, si dhe lejohen mëditjet për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci dhe Enis Kervan, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Budapest (Hungari), nga 2 - 5 nëntor 2021.

13. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të biletës kthyesë në lidhje me udhëtimin zyrtar në Budapest (Hungari)

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e biletës kthyesë të udhëtimit, në shumën prej 380,00 euro, nga anulimi i udhëtimit zyrtar të deputetit Arben Gashi, i paraparë të realizohet në Budapest (Hungari), prej 2 - 5 nëntor 2021.

* * *

Në lidhje me udhëtimet zyrtare të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, nënkryetarja e Kuvendit - njëherësh kryesuese e këtij delegacioni, Saranda Bogujevci, kërkoi nga Kryesia e Kuvendit që në lidhje me udhëtimet zyrtare të këtij delegacioni për të marrë pjesë nëpër takimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me qëllim të lehtësimit të procedurave dhe shmangies së vonesave, t'i aprovojë kërkesat për këtë qëllim.

Diskutimi i plotë i nënkryetares Saranda Bogujevci është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen dhe kërkesën e lartshënuar të shtruar nga nënkryetarja, kryetari konstatoi se për udhëtimet zyrtare që do të realizohen të këtij delegacioni të Kuvendit në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, konsiderohen të miratuara në parim.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

* * *

14. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë)

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Enis Kervan, Time Kadrijaj dhe Vlora Dumoshi u lejohej udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej 23 - 29 janar 2022.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve nëse është e nevojshme), avanci nga 200,00 euro dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

15. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Londër (Britani e Madhe)

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e deputetit Gazmend Gjyshinca për lejimin e udhëtimit zyrtar në Londër, si dhe e shtroi çështjen e kritereve për udhëtimet zyrtare të deputetëve, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar të shtruar nga kryetari diskutuan nënkryetarët e Kuvendit, Kujtim Shala dhe Saranda Bogujevci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia e shtyu shqyrtimin e kërkesës së z. Gjyshinca.

16. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve shtesë për Komisionin ad hoc

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohen mjete financiare shtesë në shumën prej 1 500,00 (njëmijë e pesëqind) euro për shpenzimet e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 8 (tetë) anëtarë nga komuniteti shqiptar

dhe 1 (një) anëtar nga komuniteti serb të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, të formuar nga Kuvendi i Kosovës, me vendimin nr. 08-V-073, datë 20. 9. 2021.

17. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bahrim Shabani për kompensimin e pagave kalimtare nga Legjislatura VI

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e deputetit Bahrim Shabani për kompensimin e pagave kalimtare për Legjislaturën VI të Kuvendit dhe i citoi “Përfundimet” nga Opinioni Ligjor i Drejtorisë për Shërbime Juridike në Administratën e Kuvendit, i përgatitur më parë, e që lidhet me kërkesën e lartshënuar.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar diskutuan: kryetari i GP Multietnik, Enis Kervan; nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala; kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, dhe kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Po ashtu, edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, dha sqarime lidhur me kërkesën e lartshënuar dhe Opinioni Ligjor të përgatitur nga Drejtoria për Shërbime Juridike në Administratën e Kuvendit.

Diskutimi i plotë i Sekretarit të Kuvendit, Ismet Krasniqi, është dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryetari deklaroi që kërkesa e lartshënuar të shqyrtohet edhe një herë tjetër.

18. Propozim-Rregullorja për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i njoftoi të pranishmit se Propozim-Rregullorja për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës u është shpërndarë.

Diskutimi i plotë i Sekretarit të Kuvendit është dhënë në transkript.

Lidhur me Propozim-Rregulloren e lartshënuar diskutuan: kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri; nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-Rregulloren e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja nr. 08-Rr-003/2021 për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Shfuqizohet Rregullorja për përdorimin e automjeteve të Kuvendit të Kosovës, nr.02-2643-1/06, datë 24 nëntor 2006.
3. Rregullorja nga pika një (1) e këtij vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit.

19. Raporti i kryesuesit të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në AP të NATO-s për punimet e Sesionit Vjeshor të kësaj asambleje

Kryesia është njoftuar me shkrim, nëpërmjet raportit nga kryesuesi i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Driton Hyseni për përcjelljen e punimeve të Sesionit Vjeshor të kësaj asambleje, të mbajtur prej 8 - 11 tetor 2021, nëpërmjet platformës online.

20. Njoftimi i kryetares së Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, për udhëtimin zyrtar të realizuar në Shkup (Maqedoni e Veriut)

Kryesia është njoftuar me shkrim nga kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, për pjesëmarrjen e një delegacioni të këtij komisioni në Konferencën “Nevoja për inovacion në mbikëqyrjen e inteligjencës”, të mbajtur në Shkup (Maqedoni e Veriut), më 10 dhe 11 nëntor 2021.

21. Emërimi i kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të grupeve të miqësisë

Kryesia i emëroi kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e (56) grupeve të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e vendeve tjera për Legjislaturën VIII, të formuara me Vendimin nr. 08-V-051, datë 27. 7. 2021.

22. Kërkesa e SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë për përkrahje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ: SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë mbështetet financiarisht në shumën prej 1 000,00 euro për fushatën tradicionale të kartolinave të fundvitit.

23. Kërkesa e znj. Elvana Shala - Ambasadore e Vullnetit të Mirë për Kosovën në Komisionin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut (IHRC)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Znj. Elvana Shala - Ambasadore e Vullnetit të Mirë për Kosovën në Komisionin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut (IHRC) i mbulohen shpenzimet e biletës së udhëtimit në shumën 1 172,20 euro, nga udhëtimi i saj në Nepal për ta pranuar çmimin e fituar “Global Youth Leadership Award 2021”.

24. Kërkesa për mbulim të tejkalimit të shpenzimeve

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i tejkalimit të shpenzimeve në shumën prej 52,40 euro (pesëdhjetë e dy euro e katërdhjetë centë) të Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për shpenzimet në bufe gjatë muajit nëntor 2021.

* * *

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hagë (Holandë)

Kryesia e shtyu shqyrtimin e kërkesës se lartshënuar.

2. Propozimi i kryetarit të GP të PDK, Abelard Tahiri, për zëvendësimin e ish-deputetit z. Uran Ismaili në Delegacionin e Përherhëm të Kuvendit të Kosovës në AP të SEECP-së

Kryesia, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 08-V-002, të datës 20. 4. 2021

Pika 3. e Vendimit nr. 08-V-002, datë 20. 4. 2021, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: “Deputeti Ferat Shala caktohet anëtar në Komisionin e Përgjithshëm për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energji të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore, në vend të ish-deputetit Uran Ismaili”.

3. Kërkesa për miratimin e shpenzimeve në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Tiranë (Shqipëri)

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohen shpenzimet e udhëtimit, transportit dhe të akomodimit (me tejkalim), si dhe lejohen mëditjet për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Dimal Basha, Ariana Musliu-Shoshi dhe Fridon Lala, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Tiranë (Shqipëri), nga 25 - 27 nëntor 2021, me llogaritjet dhe specifikat sipas kërkesës me nr. 08/1091/Do-535, datë 8. 12. 2021.

4. Kërkesa për miratimin e shpenzimeve në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Paris (Francë)

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratoohen shpenzimet e akomodimit në shumën 900,00 euro (me tejkalim në shumën 113,40 euro), si dhe mëditjet për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vlora Dumoshi dhe Enis

Kervan, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Paris (Francë), nga 1 - 4 dhjetor 2021, sipas kërkesës me nr. 08/1093/Do-537, datë 8. 12. 2021.

5. Kërkesa për miratimin e shpenzimeve në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Uashington (SHBA)

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me shpenzimet nga udhëtimi zyrtar i lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohen shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, të pjesëmarrjes dhe mëditjet për deputeten e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Shqipe Mehmeti-Selimi, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Uashington (SHBA), nga 4 - 8 dhjetor 2021.

6. Propozimi për një shtesë për nëpunësit e Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, vendosi që të punësuarve në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafit mbështetës politik, duke pasur parasysh angazhimin e shtuar të Administratës së Kuvendit jashtë orarit të punës gjatë aktiviteteve të Kuvendit në mbështetjen e trupave punues të Kuvendit: Kryesisë së Kuvendit, seancës plenare dhe komisioneve parlamentare, t'u bëhet një kompensim për vitin 2021.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 13:45 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale